



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.82/2024

Datë: 29 mars 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 6 të Rregullores 01/2014 për Procedurën e Ngritjes në Detyrë të Gjyqtarëve, në takimin 323-të, të mbajtur me datë 29 mars 2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Komisioni për rishqyrtim të ankesave të kandidatëve për ngritje në detyrë në Gjykatën Supreme, në përbërjen si në vijim:
 1. Beshir Islami, gjyqtar në Gjykatën Supreme/ kryetar i Komisionit;
 2. Qerim Ademaj, anëtar i KGJK-së / anëtar i Komisionit;
 3. Arsim Hamzaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit / anëtar i Komisionit;
 4. Avni Mehmeti, anëtar i KGJK-së / anëtar rezervë i Komisionit;
 5. Ramiz Kuqi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit / anëtar rezervë i Komisionit;
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 29 mars 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me vendimin KGJK.nr.80/2024, i datës 29 mars 2024, ka shpallur konkursin e brendshëm për tre (3) pozita të lira për gjyqtar në Gjykatën Supreme nga lëmia civile, si dhe ka themeluar Panelin për Shqyrtimin e aplikacioneve dhe intervistimin e kandidatëve.

Po ashtu, Këshilli me qëllim të mbarëvajtjes së këtij procesi në rast të ankesave përkatësisht kundërshtimeve të kandidatëve për ngritje në detyrë në këtë takim ka themeluar edhe komisionin për rishqyrtim, konform nenit 6 të Rregullores Nr.04/2023 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (01/2024) për Procedurën e Ngritjes në Detyrë të Gjyqtarëve.

Nga sa u tha si më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Sekretariatit të KGJK-së; si dhe
- Arkivit.